

V E N D I M
Nr. 31/4, datë 11.12.2000

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN SATELITOR “TVSAT VEVE”

SUBJEKTIT: “TELEVIZIONI KOMBËTAR SATELITOR” SH.A.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8655, datë 31.07.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë””, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, njëzëri:

V E N D O S I:

1. T’i japë subjektit, “TELEVIZIONI KOMBËTAR SATELITOR” sh.a. licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv satelitor privat, në fushën e transmetimeve televizive me satelit për një periudhë prej 8 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur, përmban kushtet e licencës ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.